



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.82/2012

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur në objektin e përgjithshëm, e degës së kësaj gjykate në Vushtrri) departamenti i përgjithshëm, si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, ne qështjen juridike të paditësit: Byroja Kosovare e Sigurimeve të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim kundër të paditures: "në mënyrë që nga , për rimbursim të dëmit, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës" 13.01.2014, me datë: 20.01.2014 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kérkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve kundër të paditures nga për rimbursimin e dëmit

2. **OBLIGOHET** e paditura që brenda afatit 7 ditor t'ia paguajë paditëses në emër të rimbursimit të dëmit shumën prej 160 euro me kamatë sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrushem,

3. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes padisë si dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se imbetet në tërësi sipas padisë dhe kérkesëpadisë, i propozoi gjykatës që kérkesëpadinë ta aprovoi si të bazuar, shpenzimet e procedurës i kërkoi.

E paditura që nga fillimi ë është ka shkaktuar paditësces me pretendimin se lartësia e dëmit të vlerësuar nga ana e paditësit, është më e lartë sesa dëmi i shkaktuar.

Në sjalën përfundimtare deklaroi se është e gatshme të paguajë dëmin për aq sa ajo ë ka shkaktuar dhe asgjë më shumë; ndërsa vlerësimi i shkallës së parë ka qenë i drejtë, kurse vendimi i shkallës së dytë është i pa bazuar; i propozoi gjykatës që pas vlerësimit të provave ta aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Gjkata ne shqyrtimin kryesor i administroi këto prova: Ujdia jashtëgjyqësore e dt.20.05.2011, vendimi i komisionit për trajtimin e dëmeve e dt.23.02.2011, shkresa mbi urdhëresën e transferit e dt.20.05.2011, ankesa e dt.29.03.2011, fatura e lëshuar nga MAN TRUCK dhe BUS DEUTCHLAND GMBH për e dt.19.01.2011, paraqitura e dëmit me numër e dt.01.02.2011, kopja e letërnjoftimit të personit i, aktvlerësimi i dëmit i dt.08.02.2011, kopja e polises së sigurimit lëshuar nga kompania e sigurimeve " " e dt.19.03.2010, fotodokumentacioni i mjetit motorik MAN i përfshirë në aksident, aktekspertimi i dëmit i dt.21.12.2010, transferi i bërrë nga paditësj anë drejtim të personit vendimi i komisionit i shkallës së parë i dt.23.02.2011, vendimi i dt.05.04.2011.

Pas analizimit dhe çmuarjes se provave të cekura një nga një dhe te gjitha se bashku si dhe rezultatit te krejt procedurës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 te LPK, gjykata vlerësoi se ne mes te palëve procedurale nuk janë kontestuese këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se paditësja ka lidh ujdi jashtëgjyqësore me personin , dhe se të njëjtës ia ka transferu shumën prej 271 00 euro.

Nuk është kontestuese në mes të palëve se në aksidentin e komunikacionit ka marrë pjesë e paditura dhe e njëjta ka qenë shkakatrae e aksidentit.

Në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese mbetet lartësia e dëm8.02.2011, vjen në përfundim se ky vlerësim nuk është real, madje është vlerësim i ndërhyrë, pasi fare qartë shihet se vlersimi që është bërrë me kompjuter dhe i arsyetuar është 160 euro, ndërsa më vonë me anë të shkrimit dhe kalkulimit me dotë të lirë janë futur shuma për të cilat nuk jepen arsyebindëse.

Paditësja pretendon se dëmi është vlerësuar drejtë nga shkalla e dytë e paditëses, ndërsa e paditura pohon vlerësimi shkallës së parë ka qenë i drejtë ndërsa vlerësimi shkallës së dytë nuk është i drejtë.

Gjkata nuk mund të akceptoj një vlerësim të tillë, ku nuk ipen arsyet për ato shumë, dhe nuk osrohen fakte dhe prova për vërtetësinë e faktave.

shihet se dëzentim ka pasuar vetëm mbrojtësi në anën e djathë të njëtit motorik, e jo edhe shkalla e djathë që figuron në aktvlerësim, edhe pse për të njëjtën nuk mund të kuptohet a është kalkuluar me të vërtet apo vetëm është përfshirë.

Madje edhe në raportin e policisë fare qartë përshkruhet se dëmi ekziston në mbrojtësin e përparmë ana e djathë.

Sipas nenit 321 të LPK-së secila palë ka për detyrë që të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Sipas nenit 322 paragrafi 1 thuhet citoi: "Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës", ndërsa paragrafi 2 thuhet: "Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parashev diç tjetër".

Paditësja duke vepruar konform ankesës së personit të tretë, ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe e ka ngritur shumën nga 160 në 271 euro.

Paditësja në vendimin e shkallës së dytë nuk jep arsyë pse ka ardhur deri tek ngritja e shumës së vierësimit a vetëm në bazë të pretendimeve të personit të tretë i cili ofron fatura për pjesën e dëmtuar, apo edhe në bazë të ndonjë ekspertize të brendshme, pamvarwsisht faktit se personi i tretw e ka dorwzuar edhe pro fakturwn me njw qmim tw lartw, mirwpo qw duhet tw bwhet ekspertizw pwr amortimin e pjesws sw pwr dorur, e qw nw rastin konkret nuk ka pasur, sw paku jo nw shkresat e lwendws.

Në vendimin e saj paditësja përmend parametrat teknik, çmimeve standarde në Kosovë per riparimin e një dëmi të tillë, mirëpo paditësja për të pasur të drejtë në regres nuk mjafton vetëm të lidh ujdi jashtëgjyqësore, e personin e tretë por edhe vlerësimi duhet të jetë objektiv, professional, i plotë dhe i pa ndërhyrë.

Gjykata nuk lëshohet më tutje në vlerësimin e vendimit të paditëses pasi nuk është objekt shqyrtimi, por që konsideron se në bazë të provave të lartëcekura dhe të elaboruara, kërkësëpadia e paditëses duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa për pjesën e pa argumentuar mirë nga ana e paditëses duhet refuzuar si të pa bazuar.

Sa i përket provave tjera gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e tyre sepse nuk janë relevante për të vërtetuar qështjet kontestuese mes të palëve.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenin 18.1 dhe 18.4 të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, pasi e paditura në momentin e aksidentit ka drejtuar automjetin e pa siguruar, ndërsa dëmin e shkaktuar e ka mbuluar Byroja Kosovare e Sigurimeve, e cila ka të drejtën e regresit.

Ministria e Drejtësisë, si dhe Udhëzimit Administrativ mbi Unifikimin e Takṣave  
Gjyqësore.

Me sa u tha me lartë e ne baze te nënët 143 te LPK, u vendos si ne  
diapozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE**  
**C.nr.82 /2012 Datë: 20.01.2014**

**G J Y Q T A R I**  
**Faton Ademi**

*Ademi*

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat 7 ditor nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.